

26 Kodi i Sh. B. § 1471 – Pagesat që mbahen në burim për institucionet e huaja financiare

(a) Në përgjithësi

Në rast se ndonjë pagese që mbahet në burim për një institucion financiar të huaj nuk i plotëson kërkesat e nën-seksionit (b), agjenti i mbajtjes në burim në lidhje me pagesën e tillë do të zbres dhe do të mbajë në burim nga pagesa e tillë një tatim të barabartë me 30 përqind të shumës së pagesës së tillë.

(b) Kërkesat e raportimit, etj.

(1) Në përgjithësi

Kërkesat e këtij nën-seksioni plotësohen në lidhje me një institucion të huaj financiar nëse ekziston në fuqi një marrëveshje në mes të institucionit të tillë dhe Sekretarit sipas së cilës institucioni i tillë pajtohet--

(A) për të siguruar informatat për secilin mbajtës të secilës llogari të mirëmbajtur nga institucioni i tillë aq sa është e nevojshme për të përcaktuar cila (nëse ka) nga llogaritë e tilla është llogari e Shteteve të Bashkuara,

(B) për të përmbushur verifikimin e tillë dhe procedurat e kujdesit të duhur siç mund të kërkoj Sekretari në lidhje me identifikimin e llogarive të Shteteve të Bashkuara,

(C) në rast të ndonjë llogarie të Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtur nga institucioni i tillë, të raportojë në baza vjetore informatat e përshkruara në nën-seksionin (c) në lidhje me llogarinë e tillë,

(D) për të zbritur dhe për të mbajtur një tatim të barabartë më 30 përqind të —

(i) çdo pagese passthu e kryer nga institucioni i tillë për një mbajtës të pabindur llogarie apo institucion tjetër i huaj financiar i cili nuk i plotëson kërkesat e këtij nën-seksioni, dhe

(ii) në rast të ndonjë pagese passthu e cila është kryer nga institucioni i tillë për një institucion të huaj financiar e cila ka efekt në një zgjedhje sipas paragrafit (3) në lidhje me pagesën e tillë, atë shumë të pagesës së tillë siç është e alokueshme për llogaritë e mbajtura nga mbajtësit e pabindur të llogarive apo institucionet e huaja financiare të cilat nuk plotësojnë kërkesat e këtij nën-seksioni,

(E) të përmbushur kërkesat e Sekretarit për informata shtesë në lidhje me ndonjë llogari të Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtur nga institucioni i tillë, dhe

(F) në çdo rast në të cilin çdo ligj i huaj do të (por për një heqje dorë të përshkruar në klauzolën (i)) pengonte në raportimin e çdo informate të referuar në këtë nën-seksion ose nën-seksionin (c) në lidhje me çdo llogari të Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtur nga institucioni i tillë—

(i) të përpiqet të sigurojë një akt-heqje-dorë të vlefshme dhe në fuqi të ligjit të tillë nga secili mbajtës i llogarisë së tillë, dhe

(ii) nëse një akt-heqje-dorë i përshkruar në klauzolën (i) nuk është siguruar nga secili mbajtës përbrenda një periudhe kohore të arsyeshme, të mbyllet llogaria e tillë.

Çdo marrëveshje e lidhur sipas këtij paragrafi mund të ndërpritet nga Sekretari pas konstatimit nga ana e Sekretarit se institucioni i huaj financiar nuk është në përmbushje me marrëveshjen e tillë.

(2) Institucionet financiare që konsiderohet se plotësojnë kërkesat në raste të caktuara

Një institucion i huaj financiar mund të trajtohet nga Sekretari se ka plotësuar kërkesat e këtij nën-seksioni nëse—

(A) institucioni i tillë—

(i) përmbush procedurat e tilla siç mund t'i ketë përshkruar Sekretari për të siguruar që institucioni i tillë nuk mban llogari të Shteteve të Bashkuara, dhe

(ii) plotëson kërkesat tjera të tilla siç mund t'i ketë përshkruar Sekretari në lidhje me llogaritë e institucioneve tjera të huaja financiare të mbajtura nga institucioni i tillë, apo

(B) institucioni i tillë është anëtar i një klase të institucioneve në lidhje me të cilën Sekretari ka përcaktuar se aplikacioni i këtij seksioni nuk është e nevojshme për të zbatuar qëllimet e këtij seksioni.

(3) E drejta e zgjedhjes për të mbajtur në burim në vend të mbajtjes në burim në pagesat për mbajtësit e pabindur të llogarive dhe institucionet financiare të huaja jo-pjesëmarrëse

Në rastin e një institucioni të huaj financiar që plotëson kërkesat e këtij nën-seksioni dhe kërkesa tjera të tilla siç mund t'i japë Sekretari dhe që përzgjedh aplikimin e këtij paragrafi—

(A) kërkesat e paragrafit (1)(D) nuk do të aplikohen,

(B) mbajtja e tatimit të burim e vendosur sipas nën-seksionit (a) do të aplikohet në lidhje me çdo pagesë për t'u mbajtur në burim për institucionin e tillë në masën e pagesës së tillë të caktuar për llogaritë e mbajtura nga mbajtësit e pabindur të llogarisë apo institucionet e huaja financiare të cilat nuk plotësojnë kërkesat e kësaj nën-seksioni, dhe

(C) marrëveshja e përshkruar në paragrafin (1) do të—

(i) kërkojë nga institucioni i tillë të njoftojë agjentin e mbajtjes në burim në lidhje me secilën pagesë të tillë të përzgjedhjes së institucionit sipas këtij paragrafi dhe informata tjera të tilla që mund të jenë të nevojshme për agjentin e mbajtjes në burim për të përcaktuar shumën e duhur për të zbritur dhe mbajtur në burim nga pagesa e tillë, dhe

(ii) përfshijë një aktdorëheqje nga çdo e drejtë sipas çdo marrëveshje të Shteteve të Bashkuara në lidhje me çdo shumë të zbritur dhe të mbajtur në burim në përputhje me një përzgjedhje sipas këtij paragrafi.

Deri në masën e paraparë nga Sekretari, përzgjedhja sipas këtij paragrafi mund të bëhet në lidhje me klasë apo lloje të caktuara të llogarive të institucionit të huaj financiar.

(c) Informatat që kërkohet të raportohen mbi llogaritë e Shteteve të Bashkuara

(1) Në përgjithësi

Marrëveshja e përshkruar në nën-seksionin (b) do të kërkojë që institucioni i huaj financiar të raportojë në vijim në lidhje me secilën llogari të Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtur nga institucioni i tillë:

(A) Emrin, adresën, si dhe NIT (Numrin Identifikues të Tatimpaguesit) të secili mbajtës të llogarisë i cili është një person i specifikuar i Shteteve të Bashkuara dhe, në rastin e çdo mbajtësi të llogarisë i cili është një entitet i huaj me pronësi të Shteteve të Bashkuara, emrin, adresën dhe NIT të secilit pronar domethënës të Shteteve të Bashkuara të entitetit të tillë.

(B) Numrin e llogarisë.

(C) Bilancin apo vlerën (të përcaktuar në kohë të tillë dhe në mënyrë të tillë siç mund ta parasheh Sekretari).

(D) Përveç masës së paraparë nga Sekretari, pranimet bruto dhe tërheqjet bruto apo pagesat nga llogaria (të përcaktuara për periudhën e tillë dhe në mënyrë të tillë siç mund ta parasheh Sekretari).

(2) Përzgjedhja për t'iu nënshtruar raportimit të njëjtë sikurse institucionet financiare të Shteteve të Bashkuara

Në rastin e institucionit të huaj financiar, i cili përzgjedh aplikimin e këtij paragrafi—

(A) nënparagrafët (C) dhe (D) të paragrafit (1) nuk do të aplikohen, dhe

(B) marrëveshja e përshkruar në nën-seksionin (b) do të kërkojë nga institucionet e tilla të huaja financiare të raportojnë informacionet e tilla në lidhje me secilën llogari të mbajtur të Shteteve të Bashkuara që mbahen nga institucioni i tillë kur institucionet e tilla do të kërkohej të raportonin sipas seksioneve [6041](#), [6042](#), [6045](#), dhe [6049](#) nëse—

(i) institucionet e tilla janë person i Shteteve të Bashkuara, dhe

(ii) secili mbajtës i llogarisë së tillë, i cili është person i specifikuar i Shteteve të Bashkuara apo entitet i huaj në pronësi të Shteteve të Bashkuara kanë qenë person fizik dhe qytetar i Shteteve të Bashkuara.

Një përzgjedhje sipas këtij paragrafi do të bëhet në kohën e tillë, në mënyrën e tillë, dhe do t'i nënshtrohet kushteve të tilla ashtu siç mund të parashihet nga Sekretari.

(3) Kërkesat e ndara për ndërmjetësit e kualifikuar

Në rast se një institucion financiar, i cili trajtohet si një ndërmjetës i kualifikuar nga Sekretari për qëllime të seksionit [1441](#) dhe rregulloreve të lëshuara nën të, kërkesat e këtij seksioni do të jenë krahas raportimit apo kërkesave tjera të vëna nga Sekretari për qëllime të trajtimit të tillë.

(d) Përkufizimet

Për qëllime të këtij seksioni—

(1) Llogari e Shteteve të Bashkuara

(A) Në përgjithësi

Termi "llogari e Shteteve të Bashkuara" nënkupton një llogari financiare e cila mbahet nga një apo më shumë persona të specifikuar të Shteteve të Bashkuara apo entitete të huaja në pronësi të Shteteve të Bashkuara.

(B) Përjashtimi për llogari të caktuara të mbajtura nga individë

Përveç nëse institucioni financiar përzgjedh të mos aplikoj këtë nënparagraf, termi i tillë nuk do të përfshijë ndonjë llogari të depozitave të mbajtur nga institucioni i tillë financiar nëse—

(i) secili mbajtës i llogarisë së tillë është një person fizik, dhe

(ii) për sa i përket secilit mbajtës të llogarisë së tillë, vlera agregate e të gjitha llogarive depozituese të mbajtura (në tërësi ose pjesërisht) nga mbajtësi i tillë dhe të mirëmbajtura nga institucioni financiar, i cili mirëmban llogari të tilla nuk tejkalon \$50,000.

Deri në masën e parashikuar nga Sekretari, institucionet financiare të cilat janë anëtare të të njëjtit grup të zgjeruar të ndërlidhur do të trajtohet, për qëllime të klauzolës (ii) si një institucion financiar i vetëm.

(C) Eliminimi i kërkesave dyfishe të raportimit

Termi i tillë nuk do të përfshijë ndonjë llogari financiare në një institucion financiar të huaj nëse—

(i) llogaria e tillë është mbajtur nga institucion financiar tjetër i cili i plotëson kërkesat e nën-seksionit (b), apo

(ii) mbajtësi i llogarisë së tillë përndryshe i nënshtrohet kërkesave të raportimit të informatave që i përcakton Sekretari do të bënte të domosdoshme raportimin me këtë seksion në lidhje me llogaritë e dyfishta të Shteteve të Bashkuara.

(2) Llogaria financiare

Përveç kur parashihet ndryshe nga Sekretari, termi “llogari financiare” nënkupton, në lidhje me çdo institucion financiar—

(A) çdo llogari e depozitave e mirëmbajtur nga institucioni i tillë financiar,

(B) çdo llogari kujdestare e mirëmbajtur nga institucioni i tillë financiar, dhe

(C) çdo ekuitet apo interes borxh në institucionin e tillë financiar (përveç interesave të cilat rregullisht trajtohen në një treg të themeluar të letrave me vlerë).

Çdo ekuitet apo interes borxh i cili përbën një llogari financiare sipas nënparagrafit (C) në lidhje me çdo institucion financiar do të trajtohet për qëllime të këtij seksioni sikurse të jetë i mirëmbajtur nga institucioni i tillë financiar.

(3) Entiteti i huaj në pronësi të Shteteve të Bashkuara

Termi “entiteti i huaj në pronësi të Shteteve të Bashkuara” nënkupton çdo entitet i cili ka një apo më shumë pronarë domethënës të Shteteve të Bashkuara.

(4) Institucion i huaj financiar

Termi “institucion i huaj financiar” nënkupton çdo institucion financiar i cili është një entitet i huaj. Përveç nëse parashihet ndryshe nga Sekretari, termi i tillë nuk do të përfshijë një institucion financiar i cili është i organizuar sipas ligjeve të çdo lloji të Shteteve të Bashkuara.

(5) Institucion financiar

Përveç nëse parashihet ndryshe nga Sekretari, termi “institucion financiar” nënkupton çdo entitet që—

(A) pranon depozita, gjatë punës së zakonshme të bankave apo punë të ngjashme,

(B) si pjesë substanciale të biznesit të vet, mban asete financiare për llogari të tjetërkujt, ose

(C) është angazhuar (apo mban veten jashtë si i angazhuar) kryesisht në biznes të investimeve, riinvestimeve, apo tregtimin e letrave me vlerë (sikurse është e definuar në seksionin [475 \(c\)\(2\)](#) pa marrë parasysh fjalinë e fundit të përmendur), interesave të ortakërisë, artikujve (sikurse janë përkufizuar në seksionin [475 \(e\)\(2\)](#)), apo çdo interes (duke përfshirë një kontratë apo mundësi e të ardhmes apo që është përpara) në letrat e tilla me vlerë, interesat e tilla të ortakërive apo artikujt e tillë.

(6) Mbajtësi i pabindur i llogarisë

Termi "mbajtës i pabindur i llogarisë" nënkupton çdo mbajtës të llogarisë i cili—

(A) dështon të përmbush kërkesat e arsyeshme për informim duke u referuar në nën-seksionin (b)(1)(A) ose (c)(1)(A), apo

(B) dështon të ofrojë një dokument për heqje dorë të përshkruar në nën-seksionin (b)(1)(F) kur kërkohet.

(7) Pagesa passthu

Termi "pagesë passthu" nënkupton çdo pagesë të mbajtur apo pagesë tjetër deri në masën që i atribuohet një pagese të mbajtur.

(e) Grupet e ndërlidhura

(1) Në përgjithësi

Kërkesat nga nën-seksionet (b) dhe (c)(1) do të aplikohen—

(A) në lidhje me llogaritë e Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtura nga institucioni financiar i huaj, dhe

(B) përveç nëse parashihet ndryshe nga Sekretari, në lidhje me llogaritë e Shteteve të Bashkuara të mirëmbajtura nga secili institucion i huaj financiar (përveç ndonjë institucioni të huaj financiar i cili i plotëson kërkesat e nën-seksionit (b)) i cili është anëtar i të njëjtit grup të zgjeruar të ndërlidhur i institucionit të tillë të huaj financiar.

(2) Grupi i zgjeruar i ndërlidhur

Për qëllime të këtij seksioni, termi "grupi i zgjeruar i ndërlidhur" nënkupton një grup të ndërlidhur sikurse është përkufizuar në seksionin [1504 \(a\)](#), e përcaktuar—

(A) duke zëvendësuar "më shumë se 50 përqind" për "së paku 80 përqind" të secilit vend që shfaqet, dhe

(B) pavarësisht paragrafëve (2) dhe (3) të seksionit [1504 \(b\)](#).

Një ortakëri apo çdo entitet tjetër (ndryshe nga korporata) do të trajtohet si një anëtar i një grupi të zgjeruar të ndërlidhur nëse entiteti i tillë kontrollohet (përbrenda nënkuptimin në seksionin [954 \(d\)\(3\)](#)) nga anëtarët e secilit grup (duke përfshirë çdo entitet të trajtuar si anëtar i grupit të tillë nga arsyeja e kësaj fjalie).

(f) Përrjashtimet për pagesa të caktuara

Nën-seksioni (a) nuk do të aplikohet në ndonjë pagesë për aq sa pronari përfitues i pagesës së tillë është—

(1) çdo qeveri e huaj, çdo nënndarje politike e një qeverie të huaj, apo çdo agjenci me pronësi të plotë apo instrument i ndonjë apo më shumë të përmendura më parë,

(2) çdo organizatë ndërkombëtare apo çdo agjenci me pronësi të plotë apo instrument të përmendur,

(3) çdo bankë qendrore e huaj e emetimit, apo

(4) çdo klasë tjetër e personave të identifikuar nga Sekretari për qëllime të këtij nënseksioni aq sa paraqet rrezik të ulët të evazionit tatimor.

LII nuk ka kontroll mbi ose nuk vërteton ndonjë faqe të jashtme të Internetit që përmban lidhje (linqe) për apo referenca LII.

LII nuk ka kontroll mbi ose nuk vërteton ndonjë faqe të jashtme të Internetit që përmban lidhje (linqe) për apo referenca LII.